



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1683/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbareme të kreditorit “NLB Prishtina” sh.a, me seli ne Prishtinë adresa “Kosta Novaković” pn, ndaj debitorëve NTP “Dini” me seli ne fshatin Vllasali Komuna Novobërdë, me pronar S.V. dhe B.K. nga Novobërda ne adresën rr. “Kolonja e Vjetër”, me bazë juridike përmbareme, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore ne Gjilan - Dega në Novobërdë, CPK.nr.2/21 datës 16.09.2022, me datë 02.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e kreditorit “NLB Prishtina” sh.a, me seli ne Prishtinë adresa “Kosta Novaković” pn, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega ne Novobërdë, CPK.nr.2/21 i datës 16.09.2022, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Novobërdë, me aktvendimin e ankimuar CPK.nr.2/21 dt.16.09.2022, e ka Përfunduar procedurën përmbareme të iniciuar sipas propozimit për përmbareme te datës 10.02.2015, e zhvilluar sipas urdhrin përmbareme P.nr.73/15 ndt.13.02.2015, ne mes te kreditorit NLB Prishtina sh.a me seli ne Prishtine adresa “Kosta Novaković” pn, kundër debitorëve NTP “Dini” me seli ne fshatin Vllasali Komuna Novobërdë, me pronar S.V. dhe B.K. nga Novobërda ne adresën rr. “Kolonja e Vjetër”, për shkak se debitorët e kanë përmbushur obligimin ndaj kreditorit.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak te konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktvendimin e ankimuar ta prish, ashtu që lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në shkallë te parë.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “NLB Prishtina” sh.a, me seli ne Prishtinë adresa “Kosta Novaković” pn, me datën 10.02.2015 ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorëve NTP “Dini” me seli ne fshatin Vallsali Komuna Novobërdë, me pronar S.V. dhe B.K. nga Novobërda ne adresën rr. “Kolonja e Vjetër”, në bazë të dokumentit përmbartimor: Kontrata për Kredi Biznesi nr.KO814/70 dt.31.07.2014, Marrëveshja mbi Pengun dt.31.01.2014, Konfirmim regjistrimi R-20140221-88 nga data 21.02.2014 deri 21.02.2017, lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Zyra për Regjistrim te Pengut.

Përmbartuesi Privat Sefer SH.Arifi me seli ne Gjilan, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.72/15 dt.13.02.2015, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit t’i paguaj shumën prej 6,372.38 euro, me kamatë vjetore prej 5% dhe kamatëvonesë ditore 0.08% te llogaritura nga data 20.01.2015 deri ne pagesën definitive si edhe shpenzimet procedurale.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 16.03.2015, për te cilin ka vendosur Gjykata Themelore ne Gjilan me aktvendimin CPK 37/15, P.nr.73/15 dt.29.01.2016 me te cilin ka refuzuar prapësimin e debitorëve dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbartimor ndërsa ka detyruar debitorët te paguajnë shpenzimet për përpilimin e këtij aktvendimi. Duke vendosur sipas ankesës Gjykata e Apelit me aktvendimin AC.nr.1224/2016 dt.21.04.2016 ka refuzuar ankesat e debitorëve ndërsa aktvendimin e shkalles se parë e ka vërtetuar.

Me datën 05.02.2021 debitorët kanë ushtruar Kërkesë - Propozim për përfundim te procedurës përmbartimore sipas përmbushjes se obligimit –kredisë nr.KO814/70, me propozim që të përfundon procedura e përmbartimit sipas përmbushjes së obligimit nga debitorët dhe të ndërpritet çdo procedurë e iniciuar nga përmbartuesi privat qe ndërlidhet me çështjen P.,nr.73/15 dt.13.02.2015 dhe te shpallet përfundimi i procedurës për shkak te përmbushjes e detyrimit nga debitorët.

Ndërsa ne përgjigje te kësaj kërkesë te debitorëve, kreditori me datën 10.02.2021përmes zyrtares V.K.-Zyrtare për Kredi ka ushtruar një përgjigje lidhur me kërkesën për përfundimin e procedurës përmbartimore duke informuar Përmbartuesin Privat se klienti i tij NTP Dini nuk ka obligime kreditore ndaj bankës për kredinë nen shenjen KO814/70 , me tej shton se kredia ka qenë e lejuar sipas marrëveshjes qe kemi pasur me Sparkun, ku edhe obligimet janë inkasuar edhe nga Sparku për përfundimin obligimeve.

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega ne Novobërdë, pas vlerësimit të prapësimit dhe shkresave tjera, ka nxjerr aktvendim CPK.nr.2/21, dt.16.09.2022, me të cilin e ka Përfunduar procedurën përmbartimore ne këtë çështje për shkak se debitorët kanë përmbushur obligimin ndaj kreditorit,

duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar së me datën 10.02.2021 Banka NLB me seli ne Prishtinë, përmes zyrtares V.K.-Zyrtare për Kredi ka ushtruar një përgjigje lidhur me kërkesën për përfundimin e procedurës përbarimore duke informuar përbaruesin privat se klienti i tij NTP Dini nuk ka obligime kreditore ndaj bankës për kredinë nen shenjen K0814/70 , me tej shton se kredia ka qene e lejuar sipas marrëveshjes qe kemi pasur me Sparkun, ku edhe obligimet janë inkasuar edhe nga Sparku për përfundimin obligimeve. Andaj gjykata ka analizuar te gjitha shkresat e lëndës dhe ka ardhur ne përfundim se debitorët kanë përmbushur obligimin ndaj kreditorit duke paguar kredinë te cilën kanë pasur si obligim ndaj kreditorit, andaj gjykata vendosi si ne dispozitiv te këtij aktvendimi, konform nenit 66 par.4 te LPP.

Gjykata e Komerciale -Dhoma e Shkallës Së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së. Aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, sepse arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të paqarta. Gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë me çka ka ardhur edhe deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale.

Në këtë kontekst dhe në shiqim të shkresave te lëndës, përkatësisht propozimin për përbarim, kjo gjykatë vlerëson se kreditori përpos kërkesës për përmbushje te borxhit kryesor ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale, ndërsa gjykata e shkallës së parë ka vendosur për përfundim të procedurës për borxhin kryesor, por jo edhe për çështjen e shpenzimeve procedurale. Në lidhje me këtë rast neni 465 par.3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore ne Kosovë (LPK) parasheh qe: *“Kur anulohet vendimi, kundër të cilit është paraqitur mjeti i goditjes dhe lënda kthehet për rigjykim, do të lihet që për shpenzimet lidhur me procedurën sipas mjetit të goditjes të vendoset me vendimin përfundimtar”* e që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur për shpenzimet procedurale ne aktvendimin e atakuar.

Andaj me qëllim të vendosjes për shpenzimet procedurale te cilat i ka kërkuar kreditori përmes propozimit për përbarim por te cilat nuk janë precizuar dhe për te cilat nuk ka vendosur, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të bëjë eliminimin e shkeljeve të lartcekura, dhe konform nenit 463 par.2 te LPK i cili parasheh qe *“Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t'i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës”*, te kërkoj nga pala kreditore precizimin e shpenzimeve procedurale, arsye kjo për te cilën kjo gjykate vendosi që aktvendimin e atakuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej në shkallë të parë në rigjykim dhe rivendosje.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1683/23 me datë 02.05.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha